



SHOQATA 'GRUAJA,
PAQJA, SIGURIA'

With the support of

WOMEN FUND FOR GENDER EQUALITY

STRATEGJI ORIENTUESE

KOALICIONI

"GRATË

SIGURI

PAQE"





SHOQATA 'GRUAJA,
PAQJA, SIGURIA'



STRATEGJI ORIENTUESE

Koalicioni "GRATË SIGURI PAQE"

Tiranë, Janar 2019

Shkurtime

AWEN	Rrjeti për Fuqizimin e Grave Shqiptare
BE	Bashkimi Evropian
FGE	Fund for Gender Equality
GSP	Gratë Siguri Paqe
KS	Këshilli i Sigurimit
NJA	Njesitë Administrative
NJQV	Njesitë e Qeverisjes Vendore
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
OSHC	Organizatat e Shoqërisë Civile
PKV	Plani Kombëtar i Veprimit

Falenderime

Axhenda "Gratë, Paqja dhe Siguria" (WPS) është një axhendë ndërkombëtare e bazuar në parimin që *"përfshirja efektive e perspektivave gjinore mund të ketë një ndikim të rëndësishëm dhe pozitiv në jetën e grave, burrave, vajzave dhe djemve në terren"*. Axhenda ka patur një sërë zhvillimesh dhe përparime në shumë vende të botës, dhe në mënyrë specifike dhe në rajonin e Ballkanit, prandaj përparimi dhe zhvillimi i kësaj axhende dhe në Shqipëri është tashmë një domosdoshmëri, duke marrë parasysh sfidat dhe vështirësitë me të cilat përballemi sot në realitetin shqiptar.

Shoqëria civile ka luajtur dhe luan një rol të qenësishëm, si gjatë procesit të hartimit ashtu dhe në zbatimin e Planit të Veprimit të Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara mbi Gruan Paqen e Sigurinë. "Shoqata e Grave me Probleme Sociale", tashmë Shoqata 'Gruaja, Siguria Paqja', ka qenë një nga drejtuesit kryesorë në hartimin e planit të projektit për zbatimin e Rezolutës 1325 dhe ka iniciuar ngritjen e Koalicionit për të forcuar më tej rolin e shoqërisë civile dhe kontributin e saj proaktiv në angazhimet që lidhen me Rezolutën 1325 të OKB-së në Shqipëri.

Koalicioni "Gratë, Siguria dhe Paqja (CwSP) që është themeluar nga një grup i organizatave të shoqërisë civile nga e gjithë Shqipëria për të promovuar punën për çështjet e grave, paqes dhe sigurisë në Shqipëri, është një pjesë thelbësore e përpjekjeve kombëtare, duke e parë këtë si një strukturë shumë të domosdoshme në lëvizjen e tërë mekanizmave qeveritare, në nivel qendror dhe lokal përse i përket axhendës kombëtare Gruaja Paqja dhe Siguria.

Unë besoj fort që Koalicioni do të shërbejë si një strukturë këshilluese për agjencitë zbatuese të Planit Kombëtar të Veprimit, përmes pjesëmarrjes së tij në mekanizmat e zbatimit të Planit, angazhimit me rrjetet e tjera të grave, rrjetet dhe koalicionet e sigurisë, monitorimit periodik të nismave të ndërmarra nga ana e strukturave shtetërore në kuadër të implementimit të Planit Kombëtar të Veprimit, dhe angazhimit të vazhdueshëm në procese konsultimi dhe hartimi politikash.

Strategjia Orientuese e Koalicionit për 2019-2021, rezultat i një procesi inovativ të bazuar në qasjen e bashkë-kreativitetit, në veçanti thekson rëndësinë e angazhimit të shoqërisë civile në shtyrjen përpara të axhendës "Gruaja, Paqja dhe Siguria" në nivel vendi. Dëshiroj që t'i adresoj falenderimet dhe mirënjohjet grupit të ekspertëve të cilët ofruan suportin e tyre, përmes zhvillimit të aktiviteteve dhe iniciativave të ndërmarra nga grupi i monitorimit, lobimit dhe ndërgjegjësimit, Z. Myftar Doçi, Eralda Çani, Ines Leskaj dhe Dila Nikolli.

Në emër të Shoqatës, dua të shpreh mirënjohjen time të veçantë për partnerët ndërkombëtarë që na kanë mbështetur në këtë nismë, si UN WOMEN/FGE, Ambasada e Hollandës dhe OSBE. Falenderojmë në mënyrë të veçantë UN Women dhe UN Women Shqipëri që kontribuan në finalizimin e këtij dokumenti. Ata kanë mbështetur përpjekjet tona për themelimin e Koalicionit, si dhe kanë luajtur një rol të rëndësishëm në lehtësimin e procesit të hartimit dhe miratimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Rezolutën e OKB-së 1325. Mirënjohje e veçantë i adresohet edhe Re-Think Team për suportin e dhënë në realizimin e ecurisë së projektit tonë duke i ofruar një destinacion kuptimplotë objektivave tona të përbashkëta.

Duke uruar shumë suksese Koalicionit, mbetem me shpresë plot që kjo strukturë do të jetë një mekanizëm i fuqishëm në sigurimin e zbatimit të tërë angazhimeve të shtetit shqiptar përse i përket axhendës "Gruaja, Paqja dhe Siguria" në Shqipëri .

Bajana Çeveli

Drejtoreshë Ekzekutive

Shoqata 'Gruaja, Siguria, Paqja'

Përmbajtja

1. Hyrje	7
2. Koalicioni "Gratë Siguri Paqe"	8
3. Fushat prioritare, qëllimet dhe objektivat strategjike, strategjitë kryesore për arritjen e qëllimeve dhe objektivave	10
4. Palët kryesore të interesuara dhe supozibet bazë.....	15
5. Zhvillimi institucional i Koalicionit.....	17
6. Anekset	19
- Aneks 1: Fushat e politikës, objektivat dhe masat e PKV ku është parashikuar përfshirja dhe bashkëpunimi me OSHC-të	19
- Aneks 2: Analiza e mjedisit të brendshëm dhe të jashtëm të Koalicionit	20
- Aneks 3: Plani i Punës për 2019.....	21
- Aneks 4: Anëtarët e Koalicionit.....	26

1. Hyrje

Orientimet Strategjike janë zhvilluar në momentin kur Koalicioni "Gratë Siguri Paqe" (Koalicioni GSP) ka hyrë në një periudhë të rëndësishme të veprimtarisë së tij, kur është angazhuar aktivisht për zbatimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe Planit Kombëtar të Veprimit të Qeverisë shqiptare të zhvilluar për zbatimin e saj.

Procesi i planifikimit strategjik shërbeu për të nxjerrë në pah identitetin e Koalicionit, arritjet kryesore të tij, si dhe përcaktimin e drejtimeve strategjike për tre vitet e ardhshme. Fushat kryesore të veprimtarisë së Koalicionit u identifikuan bazuar në bazë të konsultimeve të brendshme me anëtarët e Koalicionit, takimet e Sekretariatit të Koalicionit, seminari i planifikimit strategjik me anëtarët e Koalicionit, sipas grupeve dhe në grup të madh, dhe seminari për zhvillimin e Planeve të Veprimit të Koalicionit për vitin 2019. Prioritetet strategjike të identifikuara në Orientimet Strategjike për 2019-2021 janë në linjë me proceset e rëndësishme politike, legjislativ dhe institucionale të përcaktuara në Planin Kombëtar të Veprimit (PKV) në zbatim të Rezolutës 1325¹.

Vizioni in PKV është "një shoqëri shqiptare ku gratë kanë një rol të përforcuar dhe janë pjesëmarrëse aktive në ruajtjen e paqes, parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve, si dhe një shoqëri me kontribut të qëndrueshëm në nivel ndërkombëtar në garantimin e të drejtave të grave të përfshira në situata konfliktuale". **Misioni është** "rritja e përfaqësimit dhe e angazhimit të grave në sektorin e sigurisë, duke reduktuar stereotipat gjinorë lidhur me përfshirjen e grave në proceset dhe pozitat vendimmarrëse në fushën e sigurisë dhe përforcimi i kontributit të vendit në një politikë ndërkombëtare garantuese të të drejtave të grave e vajzave të përfshira në situata konfliktuale dhe postkonfliktuale".

Objektivi kryesor i këtij Plani Veprimi është zbatimi dhe monitorimi i Rezolutës 1325 përmes promovimit të saj në çdo nivel:

- vendor: përmes parandalimit të çdo situatë krize, si dhe forcimit të ndërgjegjësimit gjinor të popullatës;
- kombëtar: si pjesë e programit të qeverisë;
- si dhe ndërkombëtar: përmes përfshirjes aktive të vendit në aktivitetet ndërkombëtare.

Objektivat kryesorë janë të lidhur ngushtësisht me:

- Përmirësimin e dokumenteve të politikave dhe rritjen e ndërgjegjësimit për Rezolutën 1325.
- Rritjen e pjesëmarrjes së grave në fushën e sigurisë brenda e jashtë vendit.
- Krijimin e një kuadri rregullator dhe kapacitete që mundësojnë një mbrojtje dhe rehabilitim më të mirë të grave në fushën e paqes dhe sigurisë.
- Marrjen e masave për një monitorim dhe raportim më të mirë të Rezolutës 1325.

¹ Plani Ndërinstitucional i Veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325 të KSOKB-së "Mbi Gruan, Paqen dhe Sigurinë", 2018-2020, në Republikën e Shqipërisë është miratuar me VKM, Nr.524 datë 11.09.2018).

Masat që vendi synon të realizojë përmes këtij Plani Veprimi përfshijnë:

- Inkurajimin e këmbimit të eksperiencës në nivele të ndryshme rajonale, kombëtare, dhe ndërkombëtare.
- Bashkëpunimin me shoqërinë civile për zbatimin e Rezolutës 1325.
- Adresimin me aktivitete të përbashkëta për rritjen e ndërgjegjësimit të rolit të gruas në ruajtjen e paqes dhe adresimin e situatave postkonflikt: debate publike, fushata, tryeza të rrumbullakëta dhe forma të tjera të informimit publik.
- Rritjen e përfshirjes dhe e rolit të gruas në politikat e sigurisë dhe pjesëmarrjen e eksperteve gra në aktivitetet politike në sigurinë paqeruajtëse, bashkëpunimin rajonal në misionet paqeruajtëse etj., si dhe forcimin e kapaciteteve në këtë drejtim.
- Krijimin e një sistemi raportimi të zbatimit të Planit, si dhe fillimin e punës për hartimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Zbatimin e Rezolutës 1325.
- Nxitjen e interesit të përgjithshëm për Rezolutën 1325.

PKV përfshin 4 fusha të politikës, 9 objektiva dhe 40 masa. Në 3 fusha të politikës (ose 75%), 6 objektiva (ose 66%) dhe 22 masa (ose 55%), është parashikuar përfshirja dhe bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile (OSHC) që janë të angazhuara në axhendën **Gratë, Paqe, Siguri (GPS)**. **Në Anekset janë paraqitur fushat e politikës, objektivat dhe masat ku është parashikuar përfshirja dhe bashkëpunimi me OSHC-të.**

2. Koalicioni "Gratë Siguri Paqe"

Koalicioni "Gratë Siguri Paqe" (GSP) është krijuar në dhjetor të vitit 2017 në Tiranë në kuadër të projektit "Të drejtat e gruas nga koncepti në realitetin shqiptar", të mbështetur nga Fondi për Barazinë Gjinore (UN Woman) dhe i zbatuar nga Shoqata e Grave me Probleme Sociale. Koalicioni është krijuar si një bashkim jo formal dhe përbëhet nga 32 organizata të shoqërisë civile nga e gjithë Shqipëria. Koalicioni ka zgjedhur organet e tij drejtuese, Sekretariatit, drejtuesin e Sekretariatit, si dhe Koordinatorin e Koalicionit.

Koalicioni GSP u krijua me qëllimin për të nxitur qeverinë dhe shoqërinë shqiptare për zbatimin e Rezolutës 1325 të KS të OKB-së dhe Planit KOmbëtar të Veprimit të qeverisë shqiptare të adoptuar në shtator 2018. Koalicioni GSP në përgjithësi, dhe organizata kordinuese e Koalicionit, Shoqata "Gratë Siguria e Paqe" (ish Shoqata e Grave me Probleme Sociale), kanë luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin e Planit Kombëtar të Veprimit të qeverisë shqiptare në zbatim të Rezolutës 1325. Ky kontribut është theksuar në hyrjen e Planit ².

² Në hyrje të **Planit Ndërinstitucional të Veprimit** për zbatimin e Rezolutës 1325 të KSOKB-së "Mbi Gruan, Paqen dhe Sigurinë", 2018–2020, në Republikën e Shqipërisë theksohet: "Mbështetja më thelbësore është dhënë përmes projektit "Rezoluta 1325" financuar nga Ambasada e Mbretërisë së Vendeve të Ulëta dhe "Fondi për Barazinë Gjinore, UN Eoman" dhe zbatuar nga Shoqata e Grave me Probleme Sociale", dhe "Rrjeti për Fuqizimin e Gruas Shqiptare, AËEN". "Koalicioni për Rezolutën 1325" krijuar nga organizata të shoqërisë civile (OSHC) ka qenë kontribues në procesin e hartimit të këtij Plani Veprimi." (VKM, Nr.524, datë 11.09.2018).

Në këtë kontekst Koalicioni bashkëpunoi ngushtë me palët e tjera të interesuara përfshirë institucionet përgjegjëse shqiptare, sidomos Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, përfaqësitë diplomatike të Vendeve të Ulëta dhe Suedisë, Fondin për Barazinë Gjinore (UN Women) në Tiranë, Prezencën në Shqipëri të Organizatës për Siguri e Bashkëpunim në Evropë (OSBE), dhe Delegacionin e Bashkimit Evropian në Shqipëri.

Koalicioni i Shoqërisë Civile për GSP ka një rol kyç në procesin e zbatimit të Rezolutës/PKV si partner, ofrues i ekspertizës dhe si mbikëqyrës. Në këtë mënyrë, Koalicioni mbështet dhe promovon mbrojtjen e të drejtave të grave duke përfshirë formalisht rolin dhe përgjegjësitë e grave në axhendën ndërkombëtare të sigurisë, si dhe ndryshimin e konceptit të sigurisë në mbarë botën.

Fokusi kryesor i veprimtarisë së Koalicionit është monitorimi i zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit (PKV), avokimi dhe lobimi për avancimin e GPS në nivel vendor duke mobilizuar dhe orientuar burimet ekzistuese dhe të ardhshme dhe duke lehtësuar komunikimin mes shoqërisë civile, institucioneve publike përgjegjëse dhe medias. Koalicioni ka focus edhe ndërgjegjësimin e publikut shqiptar për GSP në nivel qendror dhe lokal. Në këtë kuadër, janë krijuar tre grupe tematike për të mundësuar realizimin me efektivitet të qëllimeve të Koalicionit:

- (1) Grupi i Organizatave për Monitorimin e PKV (Grupi i Punës i Monitorimit)
- (2) Grupi i Organizatave për Avokimin dhe Lobimin për GPS (Grupi i Punës i Avokimit)
- (3) Grupi i Organizatave për Rritjen e Ndërgjegjësimit Publik mbi axhendën GPS (Grupi i Punës i Ndërgjegjësimit).

Orientimet Strategjike përfshijn vizionin, misionin, qëllimet dhe objektivat strategjike për tre fushat prioritare të Koalicionit-ndërgjegjësimi publik, monitorimi i zbatimit të Rezolutës 1325/PKV dhe avokimi për zbatimin e Rezolutës 1325/PKV--si dhe zhvillimin institucional të Koalicionit për të mundësuar arritjen e qëllimeve dhe objektivave. Vizioni i Koalicionit është "një shoqëri që është e ndërgjegjshme dhe aktive, promotore dhe garantuese e të drejtave të njeriut të grave e vajzave".

Orientimet Strategjike për 2019-2021 synojnë të jenë jo vetëm një mjet i rëndësishëm për promovimin e Koalicionit, por edhe një guidë për planifikimin e aktiviteteve, projekteve dhe programeve dhe zhvillimit institucional të tij. Orientimet Strategjike do të udhëheqin anëtarët e Koalicionit në përpjekjet e tyre për ndërgjegjësimin e publikut, monitorimin e dhe avokimin për zbatimin e PKV. Ato gjithashtu ju drejtohen institucioneve qendrore dhe lokale të cilat janë përgjegjëse për zbatimin e PKV, organizatave ndërkombëtare, donatorëve, dhe medias.

3. Vizioni, fushat prioritare dhe qëllimet strategjike të Koalicionit GSP

VIZIONI

"Një shoqëri që është e ndërgjegjshme dhe aktive, promotore dhe garantuese e të drejtave të njeriut të gruas"

MISIONI

"Koalicioni Gratë Siguria Paqja kontribon në zbatimin siç duhet të Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe Planit Kombëtar të Veprimit të qeverisë shqiptare të zhvilluar në këtë kuadër nëpërmjet monitorimit të dhe avokimit dhe lobimit për zbatimin e tyre dhe ndërgjegjësimin publik për çështjet e GSP"

FUSHAT PRIORITARE

1	2	3
Ndërgjegjësimi Publik	Monitorimi i Zbatimit të Rezolutës 1325/Planit Kombëtar të Veprimit	Avokimi dhe Lobimi për Zbatimin e Duhur të Rezolutës 1325/Planit Kombëtar të Veprimit

QËLLIMET STRATEGJIKE

Ndërgjegjësim i rritur i komunitetit për GSP	Agjenda GSP është monitoruar dhe shoqëria e informuar mbi rezultatet e monitorimit.	Rezoluta 1325/Plani Kombëtar i Veprimit janë zbatuar siç duhet nga institucionet përgjegjëse
--	---	--

MONITORIMI I ZBATIMIT TË REZOLUTËS 1325/PLANIT KOMBËTAR TË VEPRIMIT

Monitorimi i zbatimit të Rezolutës 1325/PKV synon në identifikimin e problemeve në zbatimin e tyre. Gjetjet dhe rekomandimet nga monitorimi do të ndahen me institucionet përgjegjëse. Gjithashtu, ato do të përdoren për të avokuar dhe lobuar për zbatimin siç duhet të PKV sidhe adoptimin e politikave dhe ligjeve të reja të nevojshme për zbatimin sic duhet të Rezolutës 1325. Monitorimi synon institucionet përgjegjëse si Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, etj.

Qëllimi Strategjik:	Zbatimi si duhet i Rezolutës 1325/Planit Kombëtar të Veprimit nga institucionet përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor.
Objektivat Strategjike:	Strategjitë kryesore
Axhenda GSP është monitoruar	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Angazhimi i ekspertizës për monitorimin e zbatimit të Rezolutës 1325/Planit Kombëtar të Veprimit. <ul style="list-style-type: none"> - Identifikimi i ekspertëve nga Grupi i Punës i Monitorimit (GPM) dhe ekspertët e jashtëm. - Identifikimi i të rinjve si vullnetarë. - Trajnimi i tyre në çeshtjet e monitorimit. - Kontraktimi i ekspertëve për monitorimin. ✓ Zhvillimi i Raportit të Monitorimit mbi zbatimin e Rezolutës 1325/Planit Kombëtar të Veprimit për vitin 2019. <ul style="list-style-type: none"> - Zhvillimi i metodologjisë së monitorimit. - Analiza e palëve të interesuara. - Ndërlidhja e Grupit të Punës së Koalicionit për Monitorimin me Grupin Ndër-institucional të Punës të ngritur në kuadrin e zbatimit të PKV. Takime periodike me strukturat e PKV. - Zhvillimi i draftit të parë të Raportit të Monitorimit dhe diskutimi i tij me Koalicionin. - Finalizimi i Raportit vjetor të Monitorimit. - Takimi përfundimtar me Grupin Ndër-institucional të Punës të PKV. - Dërgimi i Raportit tek Grup Ndër-institucional si dhe tek palët e tjera të interesuara (Kuvendi, Kryeministria, OKB, donatorët, etj.) ✓ Rishikimi i metodologjisë së Monitorimit bazuar në mësimet e nxjerra nga zhvillimi i raportit të parë vjetor. ✓ Monitorimi vjetor i PKV sipas skemës së vitit 2019 <ul style="list-style-type: none"> - Zhvillimi i Raportit të Monitorimit mbi zbatimin e Rezolutës 1325/Planit Kombëtar të Veprimit. - Monitorimi se sa janë reflektuar rekomandimet e raportit në vitin pasardhës nga institucionet përgjegjëse.
Publiku është informuar mbi gjetjet e monitorimit	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Takime me mediat për të ndarë gjetjet dhe rekomandimet e raporteve të monitorimit (konferenca shtypi; takime individuale; komunikata për shtyp; etj.) ✓ Krijimi i partneriteteve me median për mbulimin e gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve të raporteve të monitorimit.

AVOKIMI DHE LOBIMI PËR ZBATIMIN E REZOLUTËS 1325/PKV

Avokimi dhe lobimi për zbatimin siç duhet të Rezolutës 1325/PKV synon identifikimin e problemeve lidhur me zbatimin e PKV. Gjithashtu, avokimi dhe lobimi synojnë përmirësimin e kuadrit aktual të politikave dhe legjislacionit të zhvilluara nga qeveria shqiptare për të siguruar zbatimin siç duhet të Rezolutës 1325 në Shqipëri. Avokimi për zbatimin e PKV është i lidhur ngushtë me aktivitetet e monitorimit. Ai synon institucionet përgjegjëse si Kuvendi i Shqipërisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, etj

Qëllimi strategjik	Rezoluta 1325/Plani Kombëtar i Veprimit janë zbatuar siç duhet nga institucionet përgjegjëse
Objektivat Strategjike	Strategjitë kryesore
Avokimi për zbatimin e Rezolutës 1325 dhe PKV në nivel qendror dhe lokal	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Avokim me sektorin e barazisë gjinore në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si kordinator i grupit ndër-institucional për të inicuar procesin e zbatimit të PKV. <ul style="list-style-type: none"> - dokumentet përkatëse, - takimet, - zhvillimin e raporteve, etj. ✓ Sigurimi i përfaqësimit të aktorëve të PKV: <ul style="list-style-type: none"> - Avokim me Ministrinë e linjës dhe institucionet e tjera përgjegjëse, anëtarë të grupit ndër-institucional për pjesëmarrje aktive në aktivitetin e grupit; - Identifikimi dhe përfshirja e aktorëve të tjerë nga Ministrinë e linjës për të bashkëpunuar për zbatimin e PKV. ✓ Takime me Këshillin Kombëtar të Barazisë Gjinore; Koalicioni të prezantojë para Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore ✓ Sigurimi i prezencës dhe kontributit të anëtarëve të Komisionit parlamentar të Sigurisë; ✓ Takime me përfaqësuesit e Komisionit të Sigurisë, Aleancës së Grave në Parlament, Nën-Komisionin e Barazisë Gjinore në Kuvendin e Shqipërisë mbi rëndësinë e zbatimit të PKV. ✓ Përdorimi i rrjeteve të bazuara në Rezolutën 1325 për të bërë presion mbi institucionet përgjegjëse shqiptare dhe vendim-marrësit lidhur me zbatimin sic duhet të rezolutës. ✓ Avokim me ndihmën e grave mediatore të Shqipërisë dhe Rajonit, anëtare në rrjetet ndër-qeveritare ku Shqipëria bën pjesë.

	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Aktivitete për të avokuar zbatimin e Ligjit për Masat e Dhunës në Marrëdhëniet Familjare. ✓ Aktivitete për të avokuar zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore. ✓ Inisiativa avokimi nga organizatat e Koalicionit në nivel lokal me strukturat lokale për përfshirjen e PKV në strategjitë dhe planet lokale të veprimit. ✓ Përdorimi i medias lokale dhe qendrore për paraqitjen e PKV-së dhe për të promovuar çështjen e avokimit të Koalicionit.
<p><i>Avokim për përfshirjen e balancës gjinore në aktivitetet e sektorit të sigurisë dhe përfshirjen e grave në vendim-marrje</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Fushatë avokimi-përfshirja e grave në proceset e vendim-marrjes në institucionet e sigurisë. <ul style="list-style-type: none"> - Takime me Ministrinë e Mbrojtjes dhe Ministrinë e Brendshme për përmirësimin e politikave që synojnë përfshirjen e grave në proceset vendimmarrëse. - Takime me drejtuesit e Forcave të Armatosura dhe të Policisë së Shtetit për emërimin e grave në pozicione drejtuese dhe rritjen e numrit të grave në sistemin e karrierës së sistemit të sigurisë.
<p><i>Avokim për integrimin e perspektivës gjinore në programet e edukimit për zbatimin e Rezolutës 1325</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Përgatitja e propozimeve konkrete për përfshirjen e elementëve gjinore dhe të axhendës GSP në kurrikulat e Akademisë së Forcave të Armatosura dhe Shkollës Bazë të Policisë. ✓ Takime me Akademinë e Forcave të Armatosura dhe Shkollën Bazë të Policisë për përfshirjen e propozimeve në kurrikula.
<p>Aktivitetet e avokimit konsistojnë në:</p>	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Takime ✓ Peticione ✓ Letra të hapura ✓ Deklarata publike ✓ Spote promocionale ✓ Trajnime

NDËRGJEGJËSIMI PUBLIK

Koalicioni GSP synon në rritjen e ndërgjegjësimit publik për çështjet e GSP, me fokus tek gratë dhe të rinjtë dhe tek zonat e largëta dhe rurale. Ndërgjegjësimit publik nga Koalicioni synon gjithashtu rritjen e ndërgjegjësimit të strukturave lokale, përfshirë bashkitë dhe institucionet e tjera publike lokale, për zbatimin e PKV në nivel lokal. Koalicioni do të punojë për rritjen e ndërgjegjësimit të organizatave të shoqërisë civile dhe medias lokale dhe qendrore dhe do të bashkëpunojë me to për rritjen e ndërgjegjësimit të publikut dhe të strukturave lokale.

Qëllimi Strategjik:	Ndërgjegjësimit i rritur publik për Rezolutën 1325/Planin Kombëtar të Veprimit
Objektivat Strategjike:	Strategjitë kryesore
Ndërgjegjësimit i rritur i komunitetit për GSP	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Fushata ndërgjegjësuese për njohjen e Rezolutës 1325/Planit Kombëtar të Veprimit dhe rëndësinë e tyre në nivel lokal. <ul style="list-style-type: none"> - Me burra dhe djem - Me grupe grash në komunitet - Me të rinjtë në universitete - Me qytetarët (town hall meetings). ✓ Angazhimi i të rinjve në aktivitetet e ndërgjegjësimit. <ul style="list-style-type: none"> - Zhvillimi i kurrikulave për trajnimin e të rinjve. - Trajnimi i vullnetarëve të rinj që do të angazhohen në fushatat/aktivitetet ndërgjegjësuese (trajnim i trajnerëve). - Aktivitete të edukimit informal për të rinjtë. - Konkurs me të rinjtë për esenë më të mirë mbi Rezolutën. - Vullnetarët e rinj realizojnë aktivitete ndërgjegjësimit. ✓ Angazhimi i grave aktiviste në aktivitetet e ndërgjegjësimit. <ul style="list-style-type: none"> - Trajnim me gratë me ndikim (trajnim i trajnerëve) që do të angazhohen në fushatat/aktivitetet ndërgjegjësuese. - Ndërgjegjësimiti përmes angazhimit të grave model. ✓ Angazhimi i pushtetit vendor në aktivitetet e ndërgjegjësimit. <ul style="list-style-type: none"> - Trajnimi i strukturave të qeverisjes vendore. - Trajnimi i Njësive Administrative. ✓ Vendosja e Pikave Informative në Njësitë e Qeverisjes Vendore. ✓ Lehtësimi i bashkëpunimit ndër-sektorial / ndër-institucional në nivel vendor dhe qendror.

4. Palët e interesuara dhe supozimet bazë

PALËT KRYESORE TË INTERESUARA NË AXHENDËN "GRATË PAQJA SIGURIA"

Qeveria Qendrore	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ✓ Ministria e Mbrojtjes <ul style="list-style-type: none"> - Akademia e Forcave të Armatosura ✓ Ministria e Arsimit ✓ Ministria e Europës dhe Punëve të Jashtme ✓ Ministria e Drejtësisë ✓ Ministria e Financave ✓ Ministria e Brendshme <ul style="list-style-type: none"> - Shkolla e Policisë ✓ Kuvendi i Shqipërisë <ul style="list-style-type: none"> - Komisioni i Sigurisë - Aleanca e Grave në Parlament - Nën-Komisioni i Barazisë Gjinore - Anëtarët e Parlamentit që promovojnë zbatimin e PKV.
Qeveria Lokale	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Bashkitë ✓ Këshillat Bashkiakë ✓ Njësitë Administrative
Media	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Mediat vizuale ✓ Mediat e shkruara ✓ Mediat lokale dhe kombëtare
Donatorët Organizatat Ndërkombëtare	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Fondi për Barazinë Gjinore (UN Woman) ✓ OSBE ✓ Ambasada Hollandeze ✓ Sida ✓ Ambasada Amerikane ✓ Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri
Tjetër	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Organizatat e Shoqërisë Civile jashtë Koalicionit ✓ Universitetet

SUPOZIMET BAZË

Qëllimet Strategjike	Supozimet bazë
Ndërgjegjësimit i rritur i komunitetit për GSP	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Komuniteti është i hapur kundrejt barazisë gjinore dhe axhendës GSP. ✓ Të rinjtë duan të bëjnë punë vullnetare. ✓ Stafi i strukturave lokale ka gadishmërinë dhe interesin për të mësuar dhe për t'u angazhuar. ✓ NJQV-të janë të gatshme për të investuar në rritjen e ndërgjegjësimit dhe informimit për GSP. ✓ Ka mungesë fondesh për zbatimin e rezolutës 1325. ✓ Ka mungesë të mbështetjes financiare nga qeveria qendrore. ✓ Media është e gatshme për të promovuar dhe për tu angazhuar në informimin dhe të vërtetën publike. ✓ Media dhe OSHC-të janë të gatshme të bashkëpunojnë. ✓ Media ka interes në axhendën GSP.
Axhenda GSP është monitoruar dhe shoqëria e informuar mbi arritjet e saj në Shqipëri	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Koalicioni ka ekspertizën dhe eksperiencën e mjaftueshme për të bërë monitorimin e zbatimit të Rezolutës 1325/Planit Kombëtar të Veprimit. ✓ Ka ekspertizë jashtë Koalicionit që mund të angazhohet për monitorimin e zbatimit të Rezolutës 1325/Planit Kombëtar të Veprimit. ✓ Ministritë dëshirojnë të bashkëpunojnë. ✓ Media është e gatshme për të bashkëpunuar. ✓ Donatorët janë të interesuar dhe të gatshëm të mbështesin monitorimin e zbatimit të Rezolutës 1325/Planit Kombëtar të Veprimit.
Rezoluta 1325/Plani Kombëtar i Veprimit janë zbatuar sic duhet nga institucionet përgjegjëse	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Koalicioni ka ekspertizën, eksperiencën dhe vullnetin për të avokuar për zbatimin e Rezolutës 1325/Planit Kombëtar të Veprimit. ✓ Institucionet e ndryshme janë të hapura për ndryshimet pozitive në zbatim të Rezolutës 1325/Planit Kombëtar të Veprimit. ✓ Drejtuesit e institucioneve të ndryshme kanë vullnetin për të siguruar barazinë gjinore dhe përfaqësimin e grave në proceset e vendimmarrjes në institucionet e tyre.

5. Zhvillimi institucional i Koalicionit GSP

ZHVILLIMI INSTITUCIONAL

Koalicioni është informal dhe përbëhet nga 32 organizata të shoqërisë civile nga qytete të ndryshme të Shqipërisë. Koalicioni ka zgjedhur organet e tij drejtuese: Sekretariatit, drejtuesin e Sekretariatit, si dhe KOordinatorin e Koalicionit, të cilat janë përgjegjëse për drejtimin e Koalicionit, komunikimin e brendshëm si dhe përfaqësimin e Koalicionit tek palët e interesuara dhe publiku. Duke qenë i krijuar rishtaz, Koalicioni ka zhvilluar objektivat dhe strategjitë kryesore për zhvillimin institucional të tij, për të siguruar arritjen e qëllimeve programatike-monitorimi, avokimi dhe lobimi, dhe ndërgjegjësimi publik për Rezolutën 1325/KPV.

Objektiva	Strategjitë:
<p>Forcimi organizativ i Koalicionit.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Shtimi i Koalicionit me anetarë të rinj, bazuar në Rregulloren e Brendshme, duke siguruar efikasitetin e proceseve të komunikimit dhe vendim-marrjes së brendshme. ✓ Rifreskimi i vazhdueshëm i Grupit të të Rinjve dhe shtimi i anëtarëve të tij. ✓ Zbatimi i Rregulloreve të Koalicionit lidhur me komunikimin e brendshëm dhe të jashtëm. ✓ Sigurimi i rrotacionit në përfaqësimin e anëtarëve në Sekretariat sipas Rregulloreve të Brendshme. ✓ Rishikimi i Rregulloreve bazuar në mësimet e vitit të parë të Orientimeve Strategjike dhe rishikimi periodik i saj. ✓ Përmirësimi i komunikimit të brendshëm të Koalicionit. <ul style="list-style-type: none"> - Shpërndarja e rregullt e minutave të takimeve. - Informimi i rregullt i anëtarëve të Koalicionit për aktivitetet e ndryshme të tij, sidomos kur kërkohet vendimmarrja për çështje të caktuara. - Komunikimi me email dhe Whats up ✓ Shkëmbimi i eksperiencës me koalicione të ngjashme në rajon dhe më gjërë. ✓ Zhvillimi i procesit të planifikimit strategjik. <ul style="list-style-type: none"> - Organizimi i seminareve të planifikimit strategjik (në formën e retreat) për rishikimin e Orientimeve Strategjike dhe zhvillimin e Planeve të Punës në fund të 2019 dhe në fund të 2020. - Bërja e korrektiveve të nevojshme në Orientimet Strategjike duke reflektuar ndryshimet në ambientin e brendshëm dhe të jashtëm të Koalicionit.

Objektiva:	Strategjitë:
Ngritja e kapaciteteve të anëtarëve të Koalicionit	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Ndërtim kapacitetesh i anëtarëve të Koalicionit në avokim dhe lobim (trajnim, asistencë teknike). ✓ Ndërtim kapacitetesh i anëtarëve të Koalicionit në monitorim (trajnim, asistencë teknike). ✓ Trajnimi i anëtarëve të Grupit të Punës së Monitorimit në shkrim raporti (trajnim, asistencë teknike). ✓ Hartimi i kurrikulave për trajnimin mbi avokimin, monitorimin dhe shkrimin e raporteve.
Ngritja e Fondeve për Koalicionin	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Mbjajtja e kontakteve me UN dhe kërkimi për donatorë të tjerë që kanë interes në zbatimin e Rezolutës dhe axhendës GSP. ✓ Kërkim individual për mundësitë e financimit të aktiviteteve të Koalicionit nga anëtarët individualë të Koalicionit dhe kordinimi i gjetjeve të tyre me Koalicionin. ✓ Aplikimi i përbashkët nga anëtarë të Koalicionit për zbatimin e Rezolutës. ✓ Aplikimi nga Koordinatorin i Koalicionit.
Rrjetëzimi	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Identifikimi i rrjeteve rajonale dhe ndërkombëtare të fokusuara në Gratë, Paqe, Siguri. ✓ Anëtarësimi në rrjetet rajonale dhe ndërkombëtare. ✓ Pjesëmarrja aktive në aktivitetet e rrjeteve rajonale dhe ndërkombëtare.
Marrëdhëniet publike/ komunikimi i jashtëm	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Rritja e vizibilitetit të Koalicionit. ✓ Standartizimi i paraqitjes së Koalicionit tek palët e interesuara në GSP (letra me kokë, shkrimi i letrave dhe raporteve, etj.) ✓ Përgatitja dhe shpërndarja e materialeve promociionale për Koalicionin. ✓ Sigurimi i përfaqësimit i duhur dhe dinjitoz të Koalicionit në publik (në aktivitete publike, në media, në takimet me palët e interesuara, në takimet ndërkombëtare, etj.), bazuar në Rregulloren e Brendshme. ✓ Krijimi dhe përdorimi i vazhdueshëm dhe efektiv i mediave sociale të personalizuara për Koalicionin-Facebook, Instagram, TWitter-për promovimin e Koalicionit dhe aktiviteteve të tij.

Aneksi 1: Përfshirja dhe bashkëpunimi me OSHC-të në PKV

PKV përfshin 4 fusha të politikës, 9 objektiva dhe 40 masa. Në 3 fusha të politikës (ose 75%), 6 objektiva (ose 66%) dhe 22 masa (ose 55%), është parashikuar përfshirja dhe bashkëpunimi me OSHC-të. Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur fushat e politikës, objektivat dhe masat ku është parashikuar përfshirja dhe bashkëpunimi me OSHC-të.

Objektivi	Masa gjithsej	Masa që përfshijnë OSHC-të	% e përfshirjes së OSHC-ve të angazhuara në axhendën GPS në realizimin e Masës
Fusha e Politikës 1	21	17	100 të Objektivave; 80.9% të Masave
Përmirësimi i dokumenteve të politikave dhe rritja e ndërgjegjësimit për axhendën GPS			
1.1 Forcimi i perspektivës gjinore përmes rregullave vendëse të funksionimit në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes dhe të pjesëmarrjes në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare për zbatimin e Rezolutës 1325	5	2	40 %
1.2 Integrimi i perspektivës gjinore në programet e edukimit për zbatimin e Rezolutës 1325	8	7	87%
1.3 Rritja e ndërgjegjësimit për Rezolutën 1325 dhe zbatimin e saj	8	8	100%
Fusha e Politikës 2	9	1	50% të Objektivave; 11% të Masave
Pjesëmarrja			
2.1 Përfshirja e balancës gjinore në aktivitetet e sektorit të sigurisë	5	0	0%
2.2 Rritja e përfaqësimit të grave në aktivitete vendimmarrëse dhe procese që lidhen në sigurinë dhe ruajtjen e paqes	4	1	25%
Fusha e Politikës 4	5	5	100% të Objektivave; 80% të Masave
Zbatimi dhe monitorimi i Rezolutës 1325			
4.1 Përmirësimi i bashkëpunimit për zbatimin dhe monitorimin e Rezolutës 1325 (dhe të tjerave të lidhura me të)	4	3	75%
4.2 Mbështetja e zbatimit të plotë të Rezolutës 1325 (dhe të tjerave të lidhura me të)	1	1	100%

Aneks 2: Analiza e mjedisit të jashtëm dhe të brendshëm të Koalicionit

Anët e Forta	Anët e Dobëta
<ul style="list-style-type: none"> Koalicioni është i gatshëm për të monitoruar zbatimin e PKV. Grupet tematike të përkushtuara brenda koalicionit. Koalicioni ka ekspertizë lidhur me fushat prioritare. Disa nga organizatat anëtare kanë përvojë dhe ekspertizë në monitorim, avokim dhe lobim dhe ndërgjegjësim. Përbërja e Koalicionit. Organizimi i Koalicionit. Pjesa dërmuese e anëtarëve të Koalicionit janë aktiv. Grupi i të rinjve të Koalicionit-aktiv. 	<ul style="list-style-type: none"> Komunikimi i brendshëm. Aktivizimi jo i njëjtë i anëtarëve të koalicionit. Qendrueshmëria financiare. Fonde të kufizuara që mundësojnë realizimin e aktiviteteve të shumta që lidhen me funksionimin e Koalicionit. Informimi dhe ndërgjegjësimi publik i bazuar në projekte.
Mundësitë	Pengesat
<ul style="list-style-type: none"> PKV për zbatimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit është në fuqi dhe është miratuar. Krijimi i grupit Ndër-institucional me përfaqësuesit e Ministrive të linjës Nevoja për shërbimet e Koalicionit (për iniciativa avokimi në zbatimin e PKV, në nivel qendror dhe lokal, për Planet e Veprimt në nivel lokal, etj.) Ndërgjegjësimi i publikut lidhur me GSP është më i mirë se në të kaluarën. Ka informacione dhe aktivitete ndërgjegjësimi. OSHC-të luajnë një rol aktiv në ndërgjegjësimin e publikut. Në nivel kombëtar, mediat po luajnë një rol të mirë (krahasuar me mediat në nivel lokal) në lidhje me GSP. Ka gazetarë profesionistë dhe të përkushtuar. 	<ul style="list-style-type: none"> Mungesa e raporteve nga OSHC-të. Përvojat e këqija lidhur me zbatimin e strategjive kombëtare. Mungon informimi dhe ndërgjegjësimi publik, sidomos në zonat rurale. Nivel i ulët i vetëdijes së komunitetit. Indiferenca e njerëzve ndaj çështjeve që ata mendojnë se nuk ju përkasin. Mungesa e seminareve dhe tryezave teknike për ndërgjegjësim. Promovim/vizibilitet i kufizuar nga OSHC-të. Materialet promovuese nuk kanë qenë gjithnjë efektive, nuk janë përshtatur për grupe të ndryshme (të rinj, të rritur, etj.). Media, sidomos lokale, nganjëherë luan rol negativ, nuk përcjell siç duhet mesazhin, nuk mbulon aktivitetet në se nuk ka figura publike. Niveli i programeve televizive ka rënë. Nuk ka spote promovionale në lidhje me GSP. Pushteti vendor i papërgatitur për të zbatuar PKV: <ul style="list-style-type: none"> Zyrat e Informacionit nuk funksionojnë. Faqet e internetit nuk përdoren shpesh/siç duhet Buxheti i ulët Burimet njerëzore dhe kapacitetet janë të ulëta Njësitë Administrative nuk kanë staf. Në nivel qendror, bashkëpunimi mes institucioneve është i kufizuar

Aneksi 3: Plani i Punës për vitin 2019

Nr	Aktiviteti	Afatet	Përgjegjësia	Kosto €	Burimet
	<i>Axhenda GSP është monitoruar dhe shoqëria është informuar mbi arritjet e saj në Shqipëri</i>				
1	Identifikimi i Ekspertizës-nga Grupi i Punës i Monitorimit dhe ekspertët e jashtëm (TOT e kontraktimi)	Janar	Sekretariati i Koalicionit	-	
2	Identifikimi i të rinjve vullnetarë	Janar	Grupi i të Rinjve	-	
3	Trajnimi i ekspertëve në monitorim				
3.1	Hartimi i kurrikulave për trajnimin mbi monitorim	Mars	Trajnerët	1000	UN Women
3.2	Trajnimi i anëtarëve të Grupit të Punës së Monitorimit	Shkurt	Trajnerët	2000	UN Women
4	Raporti bazë mbi monitorimin		Ekspertët	4000	UN Women
4.1	Analiza e palëve të interesuara	Mars	Ekspertët		
4.2	Zhvillohet metodologjia e monitorimit	Mars	Ekspertët		
4.3	Grupi i Punës i Koalicionit për Monitorimin ndërlidhet me Grupin Ndërinstitucional të Punës sipas PKV	Prill	Ekspertët; Sekretariati i Koalic.		
4.4	Takimet periodike me strukturat e PKV	Në vazhdimësi	Ekspertët; Sekretariati i Koalic.		
4.5	Takimi fillestar me Koalicionin: Informimi për ecurinë e punës së grupit të monitorimit	Shtator	Ekspertët; Sekretariati i Koalic.		
4.6	Drafti i parë i monitorimit	Tetor	Ekspertët		
4.7	Takimi i koalicionit: ndarja e gjetjeve	Tetor	Ekspertët; Sekretariati i Koalic.		
4.8	Zhvillimi i draftit para-përfundimtar i ndarë me Koalicionin	Nëntor	Ekspertët		
4.9	Takimi përfundimtar me Grupin Ndër-institucional të Punës sipas NAP	Nëntor	Ekspertët; Sekretariati i Koalic.		
4.10	Finalizimi i Raportit	Dhjetor	Ekspertët		

Nr	Aktiviteti	Afatet	Përgjegjësia	Kosto	Burimet
5	Dërgimi i raportit tek Grupi Nder-institucional si dhe tek palët e tjera të interesuara (parlamenti, Kryeministria, OKB, donatorët, etj.)	Dhjetor	Ekspertët; Sekretariati i Koalicionit		
6	Publikimi i gjetjeve dhe rekomandimeve të Raportit	Dhjetor	Sekretariati i Koalic.	1500	UN Woman
	Avokimi për zbatimin e Rezolutës/Planit Kombëtar të Veprimit				
7	Avokim me sektorin e barazisë gjinore në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si koordinatori i Grupit Ndër-institucional për të inicuar procesin e zbatimit të NAP (dokumentet përkatëse, takimet, zhvillimin e raporteve, etj.)	Shkurt	Koordinatori i Koalicionit; Sekretariati i Koalicionit	-	
8	Advokim me Ministrinë e linjës dhe institucionet e tjera përgjegjëse, anëtarë të Grupit Ndërinstitucional për pjesëmarrje aktive në aktivitetin e grupit	Në vazhdimësi	Koordinatori i Koalicionit; Sekretariati i Koalic.	-	
9	Identifikimi dhe përfshirja e aktorëve të tjerë nga Ministrinë e linjës për të bashkëpunuar për zbatimin e PKV	Në vazhdimësi	Koordinatori i Koalicionit; Sekretariati i Koalic.	-	
10	Takime me Këshillin Kombëtar të Barazisë Gjinore; Koalicioni të prezantojë para Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore	Prill	Koordinatori i Koalicionit; Sekretariati i Koalic.	-	
11	Takime me përfaqësuesit e Komisionit të Sigurisë, Aleancës së Grave në Parlament, Nën-Komisionin e Barazisë Gjinore në Kuvendin e Shqipërisë mbi rëndësinë e zbatimit të PKV	Prill	Koordinatori i Koalicionit; Sekretariati i Koalic.	-	
12	Përdorimi i rrjeteve të bazuara në Rezolutën për të bërë presion mbi institucionet përgjegjëse shqiptare dhe vendim-marrësit lidhur me zbatimin sic duhet të Rezolutës.	Në vazhdimësi	Koordinatori i Koalicionit; Sekretariati i Koalic.	-	
13	Përdorimi i grave mediatore të Shqipërisë dhe Rajonit, anëtare në rrjetet ndër-qeveritare ku Shqipëria bën pjesë.	Në vazhdimësi	Koordinatori i Koalicionit; Sekretariati i Koalic.	-	

14	Aktivite për të avokuar zbatimin e Ligjit për Masat e Dhunës në Marrëdhëniet Familjare	Në vazhdimësi	Koordinatori i Koalicionit; Sekretariati i Koalic. Anëtarët e Koalicionit	1000	UN Women
15	Aktivite për të avokuar zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore	Në vazhdimësi	Koordinatori i Koalicionit; Sekretariati i Koalic. Anëtarët e Koalicionit	1000	UN Women
16	Inicitive avokimi nga organizatat e Koalicionit në nivel lokal me strukturat lokale për përfshirjen e PKV në strategjitë dhe planet lokale të veprimit	Shtator	Anëtarët e Koalicionit	12000	UN Women
17	Fushatë advokimi-përfshirja e grave në proceset e vendim-marrjes në institucionet e sigurisë	Në vazhdimësi	Anëtarët e Koalicionit		
17.1	Takime me Ministrinë e Mbrojtjes dhe Ministrinë e Brendshme për përmirësimin e politikave për përfshirjen e grave në proceset vendimmarrëse	Maj	Koordinatori i Koalicionit; Sekretariati i Koalic.	-	
17.2	Takime me drejtuesit e Forcave të Armatorura dhe të Policisë së Shtetit për emërimin e grave në pozicione drejtuese dhe rritjen e numrit të grave në sistemin e karrierës së sistemit të sigurisë	Maj	Koordinatori i Koalicionit; Sekretariati i Koalicionit	-	
18	Përfshirja e elementëve gjinorë dhe axhendës GSP në kurrikula				
18.1	Përgatitja e propozimeve konkrete për përfshirjen e elementëve gjinorë dhe të axhendës GSP në kurrikulat e Akademisë së Forcave të Armatosura dhe Shkollës Bazë të Policisë.	Maj -Qershor	Ekspertët; Koordinatori i Koalicionit Sekretariati i Koalic.	3000	UN Women
18.2	Takime me Akademinë e Forcave të Armatosura dhe Shkollën Bazë të Policisë për përfshirjen e propozimeve në kurrikula.	Maj-Qershor	Ekspertët; Koordinatori i Koalicionit; Sekretariati i Koalic.	-	

Nr	Aktiviteti	Afatet	Përgjegjësia	Kosto	Burimet
	<i>Ndërgjegjësim i rritur i komunitetit për GSP</i>				
19	Fushatë ndërgjegjësuere: Të njihet Rezoluta në nivel lokal/për rëndësinë e Rezolutës - Me burra djem - Me grupe grash në komunitet - Me të rinjtë në universitete - Me qytetarët-town hall meetings	Prill-Qershor	Anëtarët e koalicionit	12000	UN Women
20	Trajnimi i vullnetarëve të rinj që do të angazhohen në fushatat/aktivitetet ndërgjegjësuere				
20.1	Rishikimi i kurrikulave për trajnimin e të rinjve	Mars	Trajnerët	1000	UN Women
20.2	Trajnimi për vullnetarët e rinj (Trajnimi i Trajnerëve)	Prill	Trajnerët	1500	UN Women
20.3	Aktivitete të edukimit informal për të rinjtë	Maj	Trajnerët	1500	UN Women
20.4	Konkurs me grupin e të rinjve për esenë më të mirë lidhur me Rezolutën.	Tetor	Kordinatori i Koalicionit	1500	UN Women
21	Trajnim me gratë me ndikim (Trajnimi i Trajnerëve) që do të angazhohen në fushatat/aktivitetet ndërgjegjësuere	Prill	Trajnerët	1500	UN Women
22	Ndërgjegjësimi përmes angazhimit të grave model	Në vazhdimësi	Kordinatori i Koalicionit Anëtarët e Koalicionit	-	
23	Zhvillimi i kapaciteteve të pushtetit lokal, për të përdorur elemente të pushtetit vendor që do të angazhohen në fushatat/aktivitetet ndërgjegjësuere				
23.1	Trajnimi i strukturave të qeverisjes vendore	Shtator	Trajnerët	6000	UN Women
23.2	Trajnimi i Njësive Administrative	Tetor	Trajnerët	6000	UN Women
23.3	Vendosja e Pikave Informative	Nëntor	Kordinatori i Koalicionit Anëtarët e Koalicionit	6000	UN Women
24	Ndërgjegjësimi i strukturave të qeverisjes vendore, njohja dhe zbatimi në nivel vendor i PKV, sidomos nga shërbimet sociale.	Në vazhdimësi	Anëtarët e Koalicionit	-	

Nr	Aktiviteti	Afatet	Përgjegjësia	Kosto	Burimet
25	Lehtësimi i koperimit ndërsektorial / institucional.	Në vazhdimësi	Kordinatori i Koalicionit; Sekretariati i Koalicionit	-	
26	Trajnimi i OSHC-ve mbi marrëdhëniet me mediat	Maj	Trajnerët	1500	UN Women
27	Hulumtime mbi rolin aktual të mediave dhe përdorimin e saj	Prill-Maj	Ekspertët	2000	UN Women
28	Takime me mediat për të krijuar partneritete me to	Në vazhdimësi	Kordinatori i Koalicionit Anëtarët e Koalicionit	-	
29	Trajnimi i gazetarëve në gazetarinë pozitive dhe median si formëzuese e shijes së publikut	Maj	Trajnerët	2000	UN Women
30	Mbulimi nga media i aktivitetit të Koalicionit				
30.1	Programe televizive për gratë e suksesshme	Tetor	Kordinatori i Koalicionit Anëtarët e Koalicionit	-	
30.2	Mbulim televiziv për Rezolutën (emission mëngjesi)	Prill	Kordinatori i Koalicionit Anëtarët e Koalicionit	-	
30.3	Përgatitja e spoteve promociionale dhe emetimi i tyre në televizionet lokale	Prill-Maj	Kordinatori i Koalicionit Sekretariati i Koalicionit	3000	UN Women
31	Përgatitja dhe shpërndarja e materialeve promociionale	Mars & në vazhdimësi	Kordinatori i Koalicionit Sekretariati i Koalicionit Anëtarët e Koalicionit	1500	UN Women
32	Promovimi i Koalicionit dhe axhendës GSP në rrjetet sociale	Në vazhdimësi			
32.1	Përditësimi dhe përdorim i faqes së Facebook.	Në vazhdimësi	Kordinatori i Koalicionit Sekretariati i Koalicionit	-	
32.2	Përdorimi i Instagram nga Grupi i të Rinjve të koalicionit	Në vazhdimësi	Kordinatori i Koalicionit Sekretariati i Koalicionit	-	

Aneksi 4: Anëtarët e Koalicionit GSP

Nr.	Organizata	Vendodhja
1	AWEN	Tiranë
2	Qendra Vatra	Vlorë
3	Agrita Vizion	Peshkopi
4	Shoqata Jona	Sarandë
5	Unë Gruaja	Pogradec
6	Gruaja tek Gruaja	Shkodër
7	Klubi Social	Korçë
8	Forumi i Gruas Elbasan	Ebasan
9	Qendra "Fëmijet Sot"	Tiranë
10	Shoqata 'Gratë Siguri Paqe'	Durrës
11	SH.P.G.F	Tiranë
12	Komiteti i Helsinkit	Tiranë
13	Gruaja Në Fokus	Durrës
14	Shoqata për Zhvillim Psiko-Social-Kulturor të Fëmijëve dhe të Rinjve	Ebasan
15	Të ndryshëm të barabartë	Tiranë
16	Shoqata e Grave të Forcave te Armatosura	Tiranë
17	Mary Word Laureto	Tiranë
18	Komiteti Rinor	Lezhë
19	Shoqata në Ndhimë të Fëmijeve dhe Grave me Probleme	Tiranë
20	Qendra Konsumatori Shqiptar	Durrës
21	Fokus - Në ndihme të fëmijëve	Tiranë
22	Atom	Peshkopi
23	CSDC	Shkodër
24	Shoqata e Gazetarëve	Elbasan
25	Dev-Aid	Tiranë
26	Për Ju nëna dhe Fëmijë	Kukës
27	Dora Prindërore	Korçë
28	E Shkuara për të ardhmen/Past for Future	Korçë
29	Përkrahje për të Rinjtë	Korçë
30	Fëmijëve Jetim	Korcë
31	IPSED	Tiranë
32	Qendra Kombëtare për Shërbime Komunitare	Tiranë